



НДЕРМАРРЈА ПУБЛИКЕ ПЕР РРУГЕ СХТЕТЕРОРЕ

ПРОГРАМИ ВЈЕТОР ПЕР НДЕРТИМ, РИКОНСТРУИМ, РЕХАБИЛИТИМ, МИРЕМБАЈТЈЕ ДНЕ МБРОЈТЈЕ ТЕ РРУГЕВЕ СХТЕТЕРОРЕ ПЕР ВИТИН 2022



ШКУР,
јанар, 2022

Në bazë të nenit 19 të Ligjit të Ndërmarrjeve Publike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 38/96, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/15, 61/15, 39/16, 64/18, 35/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 275/19) dhe nenit 20 të Statutit të Ndërmarrjes Publike të Rrugëve Shtetërore, Këshilli Drejtues miratoi Programin vjetor për ndërtim, rikonstruim, rehabilitim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve shtetërore për vitin 2022:

HYRJE

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore është themeluar më 03.01.2013 me Vendim për themelim nr. 41-10147 / 1 nga data 28.12.2012, e miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë nr. 1 nga data 02.01.2013. Ndërmarrja Publike është e regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut me numër NVA 6839673 dhe e njëjta është pasardhëse ligjore e Agjencisë për Rrugë Shtetërore Shkup.

Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore e organizon punën e saj, planifikimin, zhvillimin dhe sigurimin e të hyrave në bazë të Programit vjetor për ndërtim, rikonstruim, rehabilitim, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve shtetërore.

I.

TË HYRAT E PLANIFIKUARA DHE TË ARDHURAT NGA KREDITË E HUAJA TË NDËRMARRJES PUBLIKE TË RRUGËVE SHTETËRORE PËR VITIN 2022

Të hyrat e planifikuara për vitin 2022 përfshijnë me ligj burimet e parapara të financimit për kryerjen e veprimtarisë themelore të ndërmarrjes, të përcaktuara sipas Ligjit të Rrugëve Publike, edhe atë:

- 1) pjesë të akcizës nga derivatet e naftës;
- 2) kompensim për përdorimin e rrugëve publike për automjete motorike dhe rimorkio (taksë rrugore);

- 3) kompensim për përdorimin e rrugës publike, pjesë të saj ose e objektit në rrugë (taksa rrugore);
- 4) kompensim për:
 - a) vendosjen e mbishkrimeve dhe të tabelave reklamuese në pjesën mbrojtëse të rrugëve shtetërore,
 - b) lidhja e rrugës hyrëse me rrugë shtetërore,
 - c) vendosja e instalimeve në bazën e rrugës, në pjesën rrugore dhe në mbrojtëse të rrugës shtetërore,
 - ç) ndërtimi dhe shfrytëzimi i objekteve tregtare në të cilat lejohet qasja në rrugë shtetërore jashtë vendbanimit;
 - d) përdorimi i tepruar i rrugës,
 - dh) transport i jashtëzakonshëm dhe
 - e) dëm i bërë në rrugë dhe objektet rrugore;
- 5) mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 6) hua dhe kreditë dhe
- 7) të hyra të tjera

Shuma e mjeteve nga pika 1 përcaktohet me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe e njëjta nuk mund të jetë më pak se 20% e të hyrave të përgjithshme në bazë të akcizës nga derivatet e naftës. Mjetet transferohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në llogarinë e Ndërmarrjes Publike të paktën 4 herë në vit, në interval prej të paktën 3 muajve kalendarik.

➤ Ilustrim tabelor i të hyrave të planifikuara dhe të ardhurave nga kreditë e huaja për vitin 2022

TË HYRAT DHE TË ARDHURAT NGA KREDITË E HUAJA	PROGRAMI I VITIT 2021
TË HYRAT	10.343.000.000
1. Pjesë e akcizës nga derivatet e naftës	4.650.000.000
2. Taksa rrugore	3.550.000.000
3. Regjistrimi (taksa rrugore nga regjistrimi)	2.100.000.000
4. Të hyrat tjera nga puna	43.000.000
Bilans i transferuar nga viti 2021	1.000.000.000
TË ARDHURAT NGA KREDITË E HUAJA	13.317.000.000
1. Kredi nga Banka Botërore	2.757.000.000
2. Kredi nga BERZH-I	5.560.000.000
3. Kredi nga banka Eksim	5.000.000.000
Mjete nga Buxheti për vitin 2022 – për investime në infrastrukturën rrugore	5.938.874.000

GJITHSEJ

30.598.874.000

I.1 Në vitin 2022 planifikohet të realizohen të hyra në vlerë totale prej **10.343.000.000 denarëve**, dhe atë:

I.1.1 Planifikohet të rriten të hyrat e akcizës krahasuar me vitin e kaluar për shkak të rritjes së pritur të përqindjes së pjesës së akcizës e cila transferohet në NP për Rrugë Shtetërore, nga 20% në 30% për shkak të së cilës të hyrat nga pjesa e akcizës nga derivatet e naftës për vitin 2022 planifikohen të jenë **4.650.000.000 denarë**.


I.1.2 Nga kompensimi për përdorimin e rrugës publike, pjesës së saj ose objektit të rrugës (taksa rrugore), priten të hyra prej **3.550.000.000 denarë**. Të hyrat e përgjithshme mbi këtë bazë llogariten sipas frekuencës së realizuar të trafikut sipas llojeve dhe kategorive të automjeteve në vitin 2021 dhe të hyrave të realizuara nga vitet e mëparshme dhe në përputhje me Vendimin për shumën dhe mënyrën e pagesës së kompensimit për përdorimin e rrugës (taksës rrugore), ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 118/19). Këto të hyra janë rritur në krahasim me të hyrat e realizuara në vitin 2021 dhe vitet e mëparshme sepse deri në fund të tremujorit të parë të vitit 2022 pritet që dy stacione të reja të taksës rrugore të lëshohen në përdorim në magjistralen Milladinovc- Shtip.

I.1.3 Të hyrat e planifikuara nga kompensimi për përdorimin e rrugëve publike për automjete motorike dhe rimorkio (taksë rrugore) që paguhet gjatë **regjistrimit** të automjeteve, janë **2,100,000,000 denarë**. Të hyrat janë planifikuar dhe realizohen në përputhje me Vendimin për shumën dhe mënyrën e pagesës së kompensimit për përdorimin e rrugëve publike për automjete motorike dhe rimorkio (taksë rrugore) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 118/09) dhe Vendimin për ndryshimin e Vendimit për shumën dhe mënyrën e pagimit të kompensimit për shfrytëzimin e rrugëve publike për automjete motorike dhe rimorkio (taksë rrugore) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 103/14), si dhe në bazë të të hyrave të realizuara nga vitet paraprake mbi këtë bazë.

I.1.4 Të hyrat e tjera nga puna në vitin 2022 pritet të jenë **43,000,000 denarë**, ndërsa planifikohet të realizohen nga kompensimet që paguhet në rrugët magjistrale dhe ato rajonale, dhe atë:

- vendosja e mbishkrimeve dhe e tabelave reklamuese në pjesën mbrojtëse të rrugëve shtetërore,
- lidhja e rrugës hyrëse me rrugë shtetërore,
- vendosja e instalimeve në bazën e rrugës, në pjesën rrugore dhe mbrojtës të rrugës shtetërore,
- ndërtimi dhe shfrytëzimi i objekteve tregtare në të cilat lejohet qasja në rrugë shtetërore jashtë vendbanimit;
- përdorimi i tepruar i rrugës,
- transport i jashtëzakonshëm
- dëm i bërë në rrugë dhe objektet rrugore dhe të tjera.

I.1.5 Ilustrim grafik i të hyrave të planifikuara për vitin 2022




I.2 Në vitin 2022 planifikohet të realizohen të ardhura nga kredi të huaja në vlerë të përgjithshme prej **13.317.000.000 denarëve**, dhe atë:

I.2.1 Nga Banka Botërore, për financim të projekteve priten të ardhura prej **2.757.000.000 denarëve**,

I.2.2 Nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim priten të ardhura prej **5.560.000.000 denarëve**,

I.2.3 Nga Banka Eksim, për vitin 2021 planifikohet të tërhiqen mjete prej **5.000.000.000 denarëve**.

I.2.4 Ilustrim grafik i të ardhurave të planifikuara nga kredi të huaja për vitin 2022



I.2.4 Në Buxhetin e RMV-së për vitin 2022 – Ministria e Transportit – Nënprogrami 2M – Investime në infrastrukturën rrugore – Subvencione kapitale për ndërmarrje dhe organizata joqeveritare janë paraparë **5.938.874.000 denarë** për realizimin e projekteve në përputhje me Ligjin për përcaktimin e interesit publik dhe nominimin e partneritetit strategjik për zbatimin e Projektit për ndërtimin e Korridorit 8 të infrastrukturës (segmenti: Tetovë – Gostivar – Bukojçan dhe Projektit të autostradës Trebenishtë – Strugë – Qafë – Thanë) dhe Koridori 10d (segmenti i autostradës Prilep – Manastir) në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

II.

SHPENZIME TË PLANIFIKUARA, SHLYERJE TË KREDIVE DHE PROGRAMI I INVESTIMIT I NDËRMARRJES PUBLIKE PËR RRUGË SHTETËRORE PËR VITIN 2022

Në vitin 2022, për investime, shlyerje të kredive dhe shpenzime, planifikohen mjete në vlerë totale prej **30.598.874.000 denarë**.


➤ Ilustrim tabelor për investimet e planifikuara, shlyerjen e kredive dhe të shpenzime për vitin 2022

SHPENZIME, SHLYERJE TË KREDIVE DHE INVESTIME	30.598.874.000
SHPENZIME	2.954.300.000

1. Shpenzime për materiale harxhuese të zyrës, inventar i imët dhe karburant	22.000.000
2. Shërbime për mirëmbajtje të rrugëve, mirëmbajtje të objekteve dhe pajisjeve, shërbime komunale dhe shërbime të tjera	1.676.300.000
3. Paga dhe shtesa të tjera për punonjësit	385.000.000
4. Transferim drejt NVL-ve për mirëmbajtjen e rrugëve komunale dhe rrugicave	300.000.000
5. Taksa, kthim të mjeteve nga regjistrimi, provizione bankare dhe shpenzime të tjera nga puna	574.000.000
SHLYERJA E NORMËS SË INTERESIT DHE KRYEGJËSË NGA KREDITË E MARRA	5.533.100.000
1. Shlyerja e normës së interesit për kreditë e marra nga kreditorët e huaj	815.000.000
2. Shlyerja e kryegjësë për kreditë e marra nga kreditorët e huaj	4.400.000.000
3. Shlyerje e borxhit të riprogramuar në MF	318.100.000
PROGRAMI I INVESTIMEVE	22.111.474.000
1. INVESTIME NGA MJETET VETANAKE	2.855.600.000
1.1 Ndërtim të rrugëve, ndriçim, sinjalizim, ura, tunele, rrëshqitje të tokës dhe pjesëmarrje vetanake në investime nga kreditë e huaja	1.509.800.000
1.1.1 Ndërtim të rrugëve	896.600.000
1.1.2 Sinjalizim dhe paisje rrugore	15.000.000
1.1.3 Rrëshqitje të tokës dhe rehabilitim të urave dhe tuneleve, dhe punime të tjera	256.200.000
1.1.4 Pjesëmarrje vetanake në investime me kredi të huaja	342.000.000
1.2. Mirëmbajtje investuese të rrugës	714.000.000
1.3. Shpronësim	200.000,000
1.4. Projektim dhe mbikëqyrje	374.100.000
1.5. Pajisje dhe softuer	57.700.000
1.6. Mjete buxhetore për ndërtimin e segmentit të autostradës: Tetovë – Gostivar – Bukojçan, dhe Trebenishtë – Strugë – Qafë – Thanë, dhe Prilep – Manastir,	5.938.874.000

2. INVESTIME NGA KREDI TË HUAJA	13.317.000.000
2.1. Kredi nga Banka Botërore	2.757.000.000
2.1.1. Projekt për avancimin dhe zhvillimin e rrugëve	2.757.000.000
2.2. Kreditë nga BERZH-i	5.560.000.000
2.2.1. Sistemi elektronik i pagesës së taksës rrugore Korridorin 10	13.000.000
2.2.2. Projekt për ndërtimin e rrugëve nacionale	4.383.000.000
2.2.3. Projekti për Shtip-Radovish, ndërtim të magjistrales	293.000.000
2.2.4 Projekt për rikonstruim dhe rehabilitimin e segmentit Kriva Pallankë- Deve Bair (kufiri me R. e Bullgarisë)	300.000.000
2.2.5 Projekt për taksë rrugore në Korridorin 8	165.000.000
2.2.6 Bukojçan-Kërçovë	306.000.000
2.2.7 Shkup- Bllacë	100.000.000
2.3. Kredi nga Banka Eksim	5.000.000.000
2.4.1 Projekt për ndërtimin e autostradës Kërçovë- Ohër	5.000.000.000

➤ Ilustrim grafik i shpenzimeve të planifikuara, shlyerjes së kredive dhe investimeve në vitin 2022



II.1. Në vitin 2022 planifikohen shpenzime në vlerë totale prej 2.954.300.000 denarëve, dhe atë:

II.1.1 Për shpenzime të materialit shpenzues për zyra, inventar të imët dhe karburant janë planifikuar gjithsej **22.000.000 denarë**. Këto shpenzime janë për prokurime të: tonerë për printerë dhe fotokopjues, letër kase fiskale në stacionet pagesore, mandat arkëtimi, letër për fotokopje, karburant për gjenerator rryme dhe automjete zyrtare, pajisjet MHT për punonjësit e stacioneve pagesore, mjete higjienike dhe shpenzime të tjera.


II.1.2 Për shërbime të mirëmbajtjes së rrugëve, mirëmbajtjes së objekteve dhe pajisjeve, shërbimet komunale dhe shërbimet e tjera, janë planifikuar gjithsej **1.673.300.000 denarë**. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve janë planifikuar për mirëmbajtjen e rrugëve, nëpërmjet marrëveshjes me Ndërmarrjen Publike për Mirëmbajtjen dhe Mbrojtjen e Rrugëve Magjistrale dhe Rajonale. Përveç mirëmbajtjes së rrugëve, në këtë pikë hyjnë edhe shërbimet e mirëmbajtjes së ndërtesave, të objekteve, softuerëve dhe pajisjeve (ashensorë, fotokopjues dhe printerë, kondicionerë, automjete, gjeneratorë, central KZ, aparate KZ dhe testim të instalimit kundër rrufesë, shtypës fiskalë, sistem për vëzhgim video dhe pajisje komunikimi të SP dhe kalimet kufitare, sistemi i pagesës së pikave pagesore, etj), shërbime komunale, shërbime higjienike, energji elektrike, provizion për shoqatat e inspektimit teknik, avokat, noter, shpenzimet e përmbaruesve dhe shërbime të tjera.

II.1.3 Për paga dhe kompensime të tjera për punonjësit (të përcaktuara me Ligj, akte nënligjore, marrëveshje kolektive, akte të ndërmarrjes, etj) janë planifikuar gjithsej **385.000.000 denarë**. Këto mjete janë të parapara për pagimin e pagës bruto dhe kompensimeve të ndryshme për punonjësit.

II.1.4 Për transferim në NJVL-të për rikonstruim dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe rrugicave, janë planifikuar mjete prej **300.000.000 denarë**. Sipas Ligjit të Rrugëve Publike mjetet transferohen te Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale pas Programit të dorëzuar për vitin aktual dhe Raportit për funksionimin e vitit paraprak.

II.1.5 Për pagimin e tatimeve, kthimin e mjeteve nga regjistrimi, provizionet bankare dhe shpenzimet e tjera operative janë planifikuar **574.000.000 denarë**. Ky grup përfshin: Tatimin mbi vlerën e shtuar, kthimin e mjeteve nga regjistrimi i automjeteve motorike dhe rimorkiove që kryejnë transport ndërkombëtar të mallrave, provizione bankare, si dhe shpenzime të tjera që dalin nga puna ditore (sigurimi i punonjësve dhe pronës, transporti i punonjësve, kontrolli sistematik, transferimi i shpejtë i dërgesave, kompensime për anëtarët e Këshillit Drejtues dhe Këshillit Mbikëqyrës, etj.)

II.1.6 Ilustrim grafik i shpenzimeve vetanake në shpenzimet e përgjithshme të planifikuara për vitin 2022



II.2 Për shlyerjen e kredive ndaj Institucioneve Ndërkombëtare Financiare, janë planifikuar mjete në vlerë totale prej 5.533.100.000 denarë, për:

II.2.1. Për shlyerjen e normës së interesit për kreditë e marra nga kreditorët e huaj, parashihen mjete në vlerë prej 815.000.000 denarëve.

II.2.2. Në bazë të shlyerjes së kryegjësë për kreditë e marra nga kreditorët e huaj, janë planifikuar mjete në vlerë totale prej 4.400.000.000 denarëve.

II.2.3. Për shlyerjen e borxhit të riprogramuar ndaj Ministrisë së Financave janë planifikuar 318.100.000 denarë. Borxhi ndaj Ministrisë së Financave buron nga shlyerja e anuiteteve ndaj Bankës Eksim, të cilat për Ndërmarjen Publike i ka kryer Ministria e Financave, dhe më pas janë lidhur marrëveshjet për riprogramimin e borxhit, gjegjësisht shlyerjen e të njejtit në 84 këste mujore.

II.3. PROGRAMI I INVESTIMEVE

Ndërmarrja Publike në vitin 2022 planifikon të realizojë mjete për investime në vlerë totale prej **22.111.474.000 denarëve**, edhe atë:

II.3.1 Për investime me mjete individuale dhe buxhetore parashihen **8.794.474.000 denarë**.

II.3.1.1 Për ndërtimin e rrugëve, rehabilitimin, rikonstruim, ndriçimin, sinjalizimin, pajisjet rrugore, urat, tunelet, rrëshqitjet e tokës, për pjesëmarrjen personale në investime të financuara nga kreditorë të huaj dhe punime të tjera janë planifikuar **1.509.800.000 denarë**.

Këto mjete janë paraparë për realizimin e projekteve të mëposhtme:

- Projekte të përfunduara, ndërsa pagesa do të ketë në vitin 2022:
 - Rindërtim të rrugës rajonale nga Shkupi deri në Qytetin e Diellit,
 - Rikonstruim i rrugës rajonale të R2133 segmenti Mateç - Likovë,
 - Rindërtimi i rrugës rajonale aksit 1 të R-418 (faza 2), në lëvizje fabrika "Vevçanka" - Shtëpia e Shëndetit Vevçan,
 - Ndërtimi i rrugës shtetërore R1402 segmenti F. Konjarevë - L. Konjarevë,
 - Ndërtimi i urës në rrugën shtetërore R2136 në lumin Pçinjë afër f.Konjarë
 - Rikonstruim me rehabilitim të rrugës shtetërore R1203, segmenti Tetovë - Xhepçishtë,
 - Rehabilitim i rrugës shtetërore A2, segmenti Kumanovë – Straçin (faza 2),

- Projektet që do të vazhdojnë me realizimin në vitin 2022:
 - Ndërtimi i urës nr. 5, lumi Lluda Mara në rrugën shtetërore R1107,
 - Ndërtimi i urës nr. 2, lumi Babuna, Bogomilë në rrugën shtetërore R2336,
 - Sanim i urës nr. 1 Llakavicë,
 - Ndërtimi i autostradës A4, segmenti PN "Bllacë" - Shkup (nyja rrugore "Stenkovec"), nënsegmenti 1 - zgjerimi i rrugës ekzistuese A4 nga PN "Bllacë" deri në fshat. Bllacë në nivelin e autostradës dhe ndërtimin e një pjese të autostradës me nyje rrugore për lidhje me rrugë lokale për në fshat. Bllacë,

- Sanim i rrëshqitjes së tokës në R2249 segmenti Melničan - Gorencë (Qendra Zhupë),
 - Sanim i rrëshqitjes së tokës dhe mureve mbajtëse në R1202, afër Jançes dhe Skudrinjes
 - Sanim i rrëshqitjes së tokës në rrugën rajonale R1308, Pretor - Markova Nogë,
 - Punimet ndërtimore të sanimit në urën nr. 1 në R2244 mbi lumin Pçinjë afër fshatit Dragomanc
 - Punimet ndërtimore të sanimit në urën nr. 3 në R1103 (Llakavicë - Negotinë)
 - Instalimi i pajisjeve rrugore nëpër taksat rrugore për të përmirësuar sigurinë në trafik
 - Sanim i rrëshqitjes së tokës në R1306, segmenti Krushevë - Sladuevë,
 - Ndërtim i rrugës rajonale R2246, Izvor (lidhje me A2) – Ura e Garskit
 - Rikonstruim i rrugës shtetërore R2133 segmenti Ropalcë –Matejç,
 - Ndërtim i magjistrales Shtip – Radovish
 - Ndërtim i autostradës Kërçovë – Ohër
 - Dhe projekte të tjera
- Projektet të cilat do të fillojnë në vitin 2022:
 - Rikonstruim i rrugës shtetërore segmenti R1109, qarkorja në Bogdanc,
 - Ndërtimi dhe zgjerimi me përmirësim të elementeve gjeometrike në rrugën rajonale R2235, segmenti Nikiforovë - Leunovë - Bunec (kryqëzimi me R1202),
 - Ndërtimi i një ure të re në lumin Pçinjë për lidhjen e autostradës së ardhshme A4, segmenti Milladinoc - Shën Nikollë - Shtip (qarkorja Konjarë i Mesëm) me rrugën rajonale R2136
 - Rikonstruim i segmentit Strumicë - Dabile
 - Rehabilitim me përmirësim të autostradës A1, PN Tabanovc – nyja rrugore Tabanovc
 - Rehabilitim dhe rriparim i rrugës shtetërore R1301, segmenti Ohër – Shën Naum
 - Rikonstruim me zhgjerim të rrugës rajonale R1109 segmenti Ponov Most – hyrja në Bogdanci,
 - Ndërtim i qarkores në Tetovë përmes nyjes rrugore Trebosh deri në Neproshten
 - Kompletimi i ndërtimit i autostradës A4, segmenti PN "Bllacë" - Shkup (nyja rrugore "Stenkovec"), nënsegmenti 1 - zgjerimi i rrugës ekzistuese A4 nga PN "Bllacë" deri

në fshat. Bllacë në nivelin e autostradës dhe ndërtimin e një pjese të autostradës me nyje rrugore për lidhje me rrugë lokale për në fshat. Bllacë,

- Kompletimi i punimeve të papërfunduara për ndërtimin e autostradës A4, segmenti Milladinoc - Shën Nikollë - Shtip,
 - Rehabilitimi i rrugës shtetërore A2, Qarkorja në Kriva Pallankë
 - Pastrim i materialit rrëshqitës dhe lehtësimin e shpateve në autostradën A4, segmenti Milladinoc - Shën Nikollë
 - Rrindërtim i nyjes rrugore Brvenicë
 - Riparimi dhe rehabilitimi i rrugëve shtetërore me kushtet e kontratës
 - Ndërtimi dhe zgjerimi me përmirësim të elementeve gjeometrike në rrugën rajonale R2235, segmenti Diga e Mavrovës – Beliçki Kanal
 - Dhe projekte të tjera
- Nëse sigurohen mjete në vitin 2022, planifikohet të fillojnë edhe projektet e mëposhtme:
 - Ndërtimi i magjistrales Manastir – Mexhitli me qarkore në Manastir
 - Ndërtim i rrugës shtetërore Strumicë – Vallandovë - kryqëzim me A1,
 - Ndërtim i rrugës shtetërore A3 qarkore në Resnjë.
 - Rehabilitim i rrugës shtetërore Hipodrom – Petrovec
 - Rehabilitim i rrugës shtetërore Milladinovci – Hipodrom,
 - Rehabilitim i rrugës shtetërore Krushevë – Demir Hisar
 - Rehabilitim i rrugës shtetërore Drugovë – Demir Hisar

II.3.1.2 Për mirëmbajtjen investuese të rrugëve parashihen **714.000.000 denarë**. Pjesa më e madhe këtyre mjeteve do të realizohen përmes Marrëveshjes me Ndërmarrjen Publike për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve magjistrale dhe rajonale, të parashikuara në Programin Vjetor për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve shtetërore për vitin 2022;

II.3.1.3 Për shpronësim të tokës, ndërtesave, pyjeve, plantacioneve dhe të mbjellave të segmentit që planifikohen për ndërtim gjatë vitit 2022, janë planifikuar **200.000.000 denarë**;

II.3.1.4 Për përgatitjen e dokumentacionit të projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit në rrugët shtetërore, parashihen mjete në vlerë prej **374.100.000 denarë**. Ky pozicion mbulon kostot për përgatitjen e studimeve fizibiliteti, projekteve të infrastrukturës,

studimeve të mjedisit jetësor, projekteve themelore dhe pjesëve të tjera të dokumentacionit tekniko-investues, siç është mbikëqyrja mbi ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve.

Në vitin 2022, planifikohet pagesa e kontratave tashmë të lidhura për përgatitjen e dokumentacionit projektues për segmentet e mëposhtme:

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për segmentin e magjistrales Manastir - Mexhitli me qarkore në Manastir,
- Përgatitja e projektit themelor për rrugën shtetërore A2 segmenti Bukojçan - Kërçovë,
- Përgatitja e projektit të infrastrukturës për rrugën shtetërore A2, segmenti Bukojçan - Kërçovë (varianti me tunel),
- Përgatitja e dokumentacionit projektues segmenti Strumicë - Vallandovë - lidhja me A1,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për sanimin e mureve mbajtës në rrugën rajonale R1202, afër fshatit Jançe dhe fshatit Skudrinjë,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues në rrugën shtetërore A3 qarkore Resnjë,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për instalimin e sinjalizimit të trafikut dhe pajisjeve në rrugën shtetërore A3, segmenti Bukovë - Ohër,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitimin e segmenteve rrugore Hipodrom - Milladinoc, Milladinoc - Petrovec dhe Petrovec - Hipodrom,
- Përgatitja dhe kompletimi i dokumentacionit projektues për lidhjen e autostradës së ardhshme A4, segmenti Milladinoc - Shën Nikollë - Shtip (nyja rrugore Konjare e Mesme) me rrugën rajonale R2136- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitimin e rrugëve shtetërore të financuara nga BERZH-i (faza II)
- Kompletimi i dokumentacionit ekzistues të projektit dhe përgatitja e një projekti infrastrukturor për rikonstruim duke zgjeruar rrugën rajonale R2236 segmenti Shën Nikollë - Neokaz,
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për sanimin e rrëshqitjes së tokës në R1306, segmenti Krushevë – Sladuevë

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rikonstruim duke zgjeruar rrugën rajonale R1109 segmenti Ponov Most - hyrja në Bogdanc,

- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për ndërtim të qarkores në Tetovë përmes nyjes rrugore Trebosh deri në Neproshtenë,

- Ndryshim dhe plotësim të projektit të infrastrukturës për ndërtimin e rrugës rajonale R2138, lidhje me rrugën rajonale R2134, me vendbanimin Qyteti i Diellit

Në vitin 2022 planifikohet përgatitja e dokumentacionit projektues për segmente të reja:

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitimin dhe sanimin e rrugës shtetërore A1, segmenti Negotinë - TEC Negotinë (të dy korsitë),

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për mbrojtjen e shpateve për autostradën A4, segmenti Milladinoc - Shën Nikollë - Shtip,

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për përfundimin e qarkores së Bogdancit që është pjesë e rrugës shtetërore R1109,

- Kompletim i dokumentacionit projektues për ndërtimin dhe zgjerimin me përmirësim të elementeve gjeometrike në rrugën rajonale R2235, segmenti Nikiforovë - Leunovë - Bunec (kryqëzimi me R1202),

- Përgatitja e projektit urbanistik dhe themelor për ndërtim të lidhjes Tetovë - Prizren (Kosovë)

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për zgjerimin dhe përmirësimin e elementeve gjeometrike në rrugën shtetërore R2234, segmenti Kondovë – Radushë – Jegunovcë,

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitim të rrugës shtetërore A1, segmenti lidhës Gjevgjeli – PN Bogorodicë (korsia e djathtë),

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për magjistrale, segmenti Strumicë – kufiti me R. e Bullgarisë
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitim të rrugës shtetërore A2, qarkores në Kriva Pallankë,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për zgjerimin e rrugës shtetërore A3, në lidhjen nga dy korsi në një, nga Delçeva për në fshatin Zvegor, për të përmirësuar sigurinë në trafik,
- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për ndërtim e një ure në lumin Vardar afër fshtit Bashino, e cili është pjesë e rrugës rajonale R1312,
- Kompletim të dokumentacionit projektues për ndërtim të rrugës rajonale R1106, segmenti Nova Breznica – Kula – Kolomot,
- Kompletim i dokumentacionit projektues për ndërtimin dhe zgjerimin me përmirësim të elementeve gjeometrike në rrugën rajonale R2235, segmenti Diga e Mavrovës – Beliçki Kanal,
- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për ndërtimin e rrugës shtetërore segmenti R1202, qarkore në Dibër (nëse kategorizohet nga rrugë lokale në atë shtetërore),
- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për ndërtimin e rrugës shtetërore Strugë – Gorna Belica – Veveçani – (nëse kategorizohet nga rrugë lokale në atë shtetërore),
- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për ndërtimin e rrugës shtetërore Srezimir – Likovo Pole –Kufiri me Republikën e Kosovës (nëse kategorizohet nga rrugë lokale në atë shtetërore),
- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për ndërtimin e rrugës shtetërore Drenovë – Jabolçishtja e Epërme – Nezhillovë – kryqëzim me rrugën rajonale R2336 (nëse kategorizohet nga rrugë lokale në atë shtetërore),
- Përgatitjen e dokumentacionit projektues për mbrojtjen e shpateve të rrugës shtetërore R1202, segmenti Mavrovi hanovi – Zhirovnicë,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për ndërtimin dhe zgjerimin me përmirësim të elementeve gjeometrike në rrugën rajonale R2235, segmenti Ropotovë – Lazhani – Zhitoshë

- dhe projekte të tjera

Nëse sigurohen mjete në vitin 2022, planifikohet të fillojnë projektet e mëposhtme:

- Përgatitja e dokumentacionit projektues për kryqëzimin e magjistrales A2, segmenti Kriva Pallanka – kryqëzim me magjistralen ekzistuese,
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për rehabilitimin dhe sanimin e rrugës shtetërore A1, segmenti Stobi - Gratsko (të dy korsitë),
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për ndërtimin e magjistrales në rrugën shtetërore A3, segmenti Koçani – Delçevë
- Përgatitja e dokumentacionit projektues për ndërtimin e magjistrales në rrugën shtetërore A3, segmenti Trebenishtë – Kosel
- dhe projekte të tjera

II.3.1.5 Për prokurimin e pajisjeve dhe softuerëve janë planifikuar **57.700.000 denarë**.

II.3.1.6 Për implementimin e Projektit për ndërtimin e Korridorit 8, (segmenti Tetovë – Gostivar – Bukojčan dhe Projektin për autostradën Trebenishtë – Strugë – Qafë –Thanë) dhe Korridorin 10d (segmenti i autostradës Prilep – Manastir) në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë paraparë **5.938.874.000 denarë** në Buxhetin e RMV-së për vitin 2022 – Ministria e Transportit - Investime në infrastrukturën rrugore – Subvencione kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare.

II.3.2 Për investime nga kreditë e huaja parashihen **13.317.000.000 denarë**, edhe atë të financuar nga: Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Eksim.

II.3.2.1 Kredi nga Banka Botërore në vlerë prej **2.757.000.000 denarë**, për projektet e mëposhtme:

-Me Projektin për avancimin dhe zhvillimin e rrugëve, të financuar nga Banka Botërore, do të financohet:

- Ndërtimi i magjistrales Rankovcë - Kriva Pallankë,
- Shërbime konsultimi: Asistenca e NPRRSH për Aktivitetet përgatitore për vendosjen e sistemit të menaxhimit me ura

- Shërbime konsultimi: Ex-ante dhe Ex-post hulumtim dhe vlerësim përdorues dhe vlerësimi i ndikimit
- Revizion teknik gjatë ndërtimit të magjstrales Rankovcë - Kriva Pallankë,
- Ekspert i prokurimit,
- Hardueri dhe softueri për sistem të menaxhimit me urat (BMS)
- Shërbime konsultimi për hulumtim të gjendjes së urave
- Shërbime konsultimi për prokurim dhe instalim të modulit analitik për ura për BMS
- dhe projekte të tjera

II.3.2.2 Kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në vlerë prej 5.560.000.000 denarë, për projektet e mëposhtme:

- **Projekti Korridor 10 – taksat rrugore**, për vendosjen e sistemit elektronik të pagesës së taksave në Korridorin 10 dhe ndërtimin e stacioneve të reja pagesore në segmentet e sapo ndërtuara të autostradës.
- **Me Projektin Program për rrugët nacionale, do të financohen:**
 - Ndërtimi i magjstrales Shtip - Koçan (Segmenti Shtip - Krupishtë dhe Segmenti Krupishtë - Koçan),
 - Ndërtimi i magjstrales Gradsko - Prilep, segmenti (Farish - Drenovë),
 - Rehabilitimi i më shumë rrugëve shtetërore: Probishtip - Krupishtë, Katlanovë - Petrovec (2 kors), Mavrovi anovi - Zhirovnicë, Gryka e Farishkës - Prilep, Makedonska Kamenicë - Sasë, dhe Kërçovë - Makedonski Brod.
 - Rehabilitimi i 5 rrugëve : Shkup - Bllacë, Podmolje - Strugë - Qafë Thanë, Manastir - Mexhitlijë, Katlanovë - Veles, Veles – Gradsko.
 - Rehabilitimi i 3 rrugëve: Milladinoc - Petrovec, Krivogashtani – Krushevë, Manastir – Demir Hisar
 - Ndihmë teknike për Njësinë për zbatimin e projektit.
 - dhe projekte tjera

- **Me Projektin segmenti rrugor Shtip - Radovish**, do të financohet ndërtimi i magjistrales Shtip - Radovish
- **Me Projektin Kriva Pallankë - Deve Bair**, do të financohet rikonstruimi dhe rehabilitimi i aksit rrugor Kriva Pallankë - Deve Bair
- **Projekti i taksave rrugore në autostrada**, do të financohet për vendosjen e sistemit elektronik të pagesës së taksave rrugore në Korridorin 8 dhe ndërtimin e stacioneve të reja pagesore në segmentet e sapo ndërtuara të autostradës.

-Shërbime konsultimi për mbështetjen e projektit për Ndërtimin dhe instalimin e stacionit të pagesës në Korridorin 8 dhe Autostradës Miladinovci – Shtip (faza 2)

- **Ndërtimi i autostradës Bukojçan - Kërçovë**, me grant fonde të siguruara nga Bashkimi Evropian dhe huamarrje nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

-Përgatitja e projektit themelor për ndërtimin e autostradës, Bukojçani – Kërçovë

-Mbikëçyrje e ndërtimit të autostradës, Bukojçani – Kërçovë,


- **Ndërtimi i autostradës Shkup - Bllacë**, me grant fonde të siguruara nga Bashkimi Evropian dhe huamarrje nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

II.3.2.4 Kredi nga Eksim Bank në vlerë prej 5.000.000.000 denarë, për financim të:

- Ndërtimit të autostradës Kërçovë – Ohër

II.3.3 Ilustrim grafik të investimeve të planifikuara në vitin 2022

INVESTIME VITI 2022



III.

Ky Program hyn në fuqi ditën e miratimit të tij, ndërsa do të fillojë të zbatohet pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

KËSHILLI DREJTUES I NP-së TË RRUGËVE SHETËRORE

KRYETAR

LJUPKA CIKAROVA

